



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

**KOMUNA E GJAKOVËS**

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Gjakovë-Djakovica-Gjakova  
**Kuvendi i Komunës - Gjakovë**  
01 Nr. \_\_\_\_\_ /2022  
Dt.07.02.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, bazuar në nenin 12 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 , nenin 18.2 shkronja e të Statutit të Komunës së Gjakovës, dhe në nenin 5.2 të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në mbledhjen e mbajtur me datë 07.02.2022, pas diskutimeve lidhur më pikën e 16 të rendit të ditës: Themelimi i Komisionit Komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” SH. A Gjakovë, e miratoi këtë :

**V E N D I M**

1. Formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” SH. A Gjakovë, në këtë përbërje:
  1. z. Flamur Fetahaj, i emëruar nga Kryetari i Komunës.
  2. znj. Albulena Zuka -Vokshi , përfaqësues i Kuvendit .
  3. z. Besim Ndau, përfaqësues i Kuvendit .
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .
3. Vendimi iu dërgohet:
  - Kryetarit të Komunës z. Ardian Gjini
  - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
  - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës,
  - Ndërmarrjes “Stacioni i Autobusëve” SH.A Gjakovë,
  - Anëtarëve të Komisionit .
  - Arkivit,

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës  
Znj. Arbëneshë Kuqi

